



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.02.2021, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Ramazan Gjuzi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 17 shkurt 2021.
2. Seancë dëgjimore me kandidatët për vendin vakant të kryetarit të KDRTSH-së.

Marrin pjesë:

Ramazan Gjuzi, Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Fatjona Dhimitri, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri,

Mungojnë:

Erion Piciri, Enada Kapllani dhe Amra Barova.

Të ftuar:

Kandidaturat:

1. Klevis Bejkolli
2. Gezim Podgorica
3. Gasper Marku
4. Ksenofon Krisafi
5. Nadia Rusi Peto
6. Leka Bungo
7. Milena Selimi *(nuk merr pjesë për arsye shëndetësore.)*

HAPET MBLEDHJA

Ramazan Gjuzi – Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Siç jeni njoftuar, sot në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbalit të datës 17 shkurt 2021.

Pika e dytë e rendit të ditës është seanca dëgjimore me kandidatët për vendin vakant të kryetarit KDRTSH-së.

Para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, verifikojmë kuorumin. Prezentë janë: Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Fatjona Dhimitri, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, ndërsa nuk janë prezent: Enada Kapllani, Erion Piciri dhe Amra Barova.

Atëherë, kuorumi i nevojshëm për të vazhduar mbledhjen plotësohet. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, me miratimin e procesverbalit të datës 17 shkurt 2021.

Kush është dakord me procesverbalin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

Sot kemi të ftuar në dëgjese 7 kandidatë, të cilët do të paraqesin platformën e tyre, si dhe do t'u përgjigjen pyetjeve të anëtarëve të komisionit.

Kandidatët janë: Klevis Bejkolli, Gëzim Podgorica, Gasper Marku, Nadia Rusi Peto, Milena Selimi, Ksenofon Krisafi dhe Leka Bungo.

Paraprakisht ju bëj me dije të gjithë kandidatëve se secili prej tyre ka 15 minuta kohë për të bërë prezantimin.

Atëherë, fillojmë me kandidatin e parë, me zotin Klevis Bejkolli.

Përshëndetje, zoti Bejkolli!

Klevis Bejkolli – Përshëndetje të gjithëve!

Ramazan Gjuzi – Fjala për ju, por shkurtimisht, ju lutem, na paraqisni të dhënat tuaja për komisionin.

Klevis Bejkolli – Në rregull!

Unë quhem Klevis Edmond Bejkolli.

Unë mendova të kandidoj për këtë pozicion, pasi dua t'i rikthej RTSH-së autoritetin e munguar afër teleshikuesit shqiptar, duke u afruar me programet dhe duke iu larguar, sipas mendimit tim, programeve radiofonike me biseda të stërzgjatura, që shpesh janë bërë shumë të lodhshme për të gjithë teleshikuesit. Megjithëse mendoj se jam më i riu nga 7 kandidatët, pavarësisht kësaj, unë jam rritur me RTSH-në, jam shumë nostalgjik nga ajo që kam parë në RTSH, i cili ka qenë i vetmi stacion televiziv që shikonim dikur. Për fatin e keq, RTSH-ja i ka humbur teleshikuesit e saj dhe mendoj se me idetë e mia, me ndihmën time mund ta rikthej sërish atje, në vendin ku ka qenë dhe i takon RTSH-së. Gjithashtu, mendoj rikthimin e disa emisioneve, të cilat, tashmë, mungojnë në RTSH, siç janë, për shembull, emisionet bujqësore dhe blegtorale, duke sjellë në ekran më shumë eksperiencë bashkëkohore, por edhe problematikat që ndeshin vetë fermerët në jetën e tyre.

Emisionet e rinisë duhet të jenë të shumëllojshme, jo vetëm shkollore, por edhe argëtuese. Pra, RTSH-ja të mos jetë vetëm pasqyruese e aktiviteteve sportive dhe argëtuese për rininë, por të jetë një shtysë dhe t'i organizojë këto aktivitete, duke mbajtur edhe vulën e RTSH-së. Gjithashtu, duhet të kemi edhe programe të tjera sportive dhe për shëndetin. Me aq informacion sa kam unë, RTSH-ja më shumë i ka marrë programet nga të tretët sesa i prodhon vetë. Unë personalisht mendoj se RTSH-ja i ka të gjitha kapitalet njerëzore dhe të tjerat për të krijuar emisione vetë me vulën RTSH-së, çka do të ishte një gjë shumë e mirë për vetë televizionin, si dhe do ta ndihmonte vetë RTSH-në për t'u rikthyer dhe për të konkurruar denjësisht me televizionet e tjera private.

Lidhur me Drejtorinë e Informacionit, mendoj se duhet të ketë kamera në shumë rrethe për të pasqyruar ngjarje, duke dhënë lajme realisht tek të parët, duke qëndruar dhe larg politikës. Dua të ndikoj në këshill njëloj si të gjithë anëtarët e tjerë të tij për ta ngritur edhe më shumë cilësinë e RTSH-së, do të bashkëpunoj më shumë edhe me organizata të tjera qeveritare dhe joqeveritare për mbështetjen dhe realizimin e programeve. Gjithashtu, kam vërejtur se departamenti i marketingut duhet të jetë më aktiv. Pra, për mendimin tim, duhet të jetë më aktiv, duhet të dalë në terren për gjetjen dhe afrimin e sponsorëve dhe mbështetësve të ndryshëm për realizimin e programeve të ndryshme.

Orkestra e RTSH-së, krahas aktiviteteve që bën, duhet të jetë më aktive sipas kërkesave të organizimeve dhe me formacione më të vogla dhe me organizime në qytete të ndryshme të

vendit. Orkestra e RTSH-së duhet të dalë në sheshin e çdo qyteti për të dhënë më të mirën e saj, çka do të bëjë që të njihet jo vetëm në RTSH, por kudo në çdo qytet të Shqipërisë. Kaq kisha.

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Bejkolli!

Ftoj anëtarët e komisionit për t'i drejtuar pyetje zotit Bejkolli.

Po, zonja Kumbaro.

Mirela Kumbaro – Një pyetje kam për ju, zoti Bejkolli. Më bëri përshtypje dhe, sigurisht, e vlerësoj faktin që ju kishit një vëmendje të veçantë për sa u përket programeve bujqësore, por a jeni në dijeni që në këtë periudhë që flasim RTSH-ja ka një kanal të dedikuar për bujqësinë që quhet “Agro RTSH”?

Klevis Bejkolli – Po, jam në dijeni dhe i di të gjitha programet, pasi kam qenë edhe pjesë e Radio Tiranës për 6 vjet ...

Mirela Kumbaro – Një kanal të dedikuar, jo një program.

Klevis Bejkolli – Të lutem. Unë, duke qenë pjesë prej 6 vjetësh në një studio me profesor Ismet Bellovën, i di shumë mirë, por programet që unë i kam parë dikur, kur kam qenë fëmijë, janë shumë larg atyre programeve që mendoj dhe kam idetë e mia që t'i realizoj. Unë dua të realizoj diçka që të jetë komplet e RTSH-së, të ketë vulën e RTSH-së, sepse vetë RTSH-ja ka aq burime njerëzore, ka furnizuar të gjitha kanalet private dhe është gjynah që të mos i shfrytëzojë vetë dhe mund të marrë më të mirën prej tyre. Unë mendoj se nuk është atje ku duhet ai kanal që ju thoni, zonja Kumbaro.

Ramazan Gjuzi –Tjetër?

Po, zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj– Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit juve!

Ismet Beqiraj – E dëgjova kandidatin kur tha se është më i riu, ndaj, të them të drejtën, prisja që të jepte mendime për vetë ambicien që ka për të bërë një revolucion teknik, administrativ dhe financiar, sigurisht, në RTSH, por gjithsesi më tërhoqi vëmendjen. Ju thatë se RTSH-së i ka rënë autoriteti, atëherë pyetja ime, që edhe ju vetë e pranuat, është: a kanë ndikuar potencialet intelektuale në drejtimin e Këshillit Drejtues të RTSH-së apo specialistët e thjeshtë, administrata teknike dhe drejtuese e RTSH-së që, në radhë të parë, nuk janë thjesht administratorë rutinë, por janë artistë, gazetarë, personalitete në fushën e artit dhe të kulturës? Ju vetë e pranuat se ka potenciale apo ka faktorët të tjerë, si mendoni? Sepse, të thuash që i ka rënë autoriteti RTSH-së...

Klevis Bejkolli – Autoriteti i ka rënë dhe këtë nuk ka nevojë ta them unë, por e thotë kushdo, pasi mjafton të shikojmë shikueshmërinë. Mua më vjen shumë keq që RTSH-ja ka shkuar në këtë pikë, sinqerisht më dhëmb, por në RTSH ka njerëz intelektualë, mjeshtra, por kam frikë se nuk stimulohen apo nuk u jepet hapësira e duhur që ata të punojnë dhe të japin më të mirën e tyre në këtë televizion. Mjafton të kujtoj që të gjitha programet apo telereportazhet Radiotelevizioni Shqiptar i merr nga të tretët. Pra, nuk ka pse t'i marrë nga të tretët, pra i bëj unë dhe ia shes RTSH-së, kur shumë bukur ka njerëz, ka regjisorë, ka artistë, ka montazhierë, ka kameramanë super të mirë në RTSH që mund t'i bëjnë këto programe dhe ato të mbajnë vulën e RTSH-së. Pse duhet të kenë vulën e dikujt tjetër? Unë nuk jam kundër që të marrim programe edhe nga të tretët, por programet duhet të jenë autentike të RTSH-së. Ndoshta jam i gabuar, por ky është mendimi im.

Gjithashtu, sepse harrova ta përmend edhe më parë, pse të mos kemi edhe ne një emision humoristik larg banalitetit, i ndryshëm dhe të mos kopjojmë të tjerët? Unë nuk dua që RTSH-ja të kopjojë të tjerët, pasi RTSH-ja është markë, është firmë dhe të tjerët duhet ta kopjojnë atë. Ju kërkoj ndjesë, pasi fola me pasion!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Bejkolli!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Atëherë, ftojme kandidatin e radhës, zotin Gëzim Podgorica.

Përshëndetje, zoti Podgorica!

Fjala për ju shkurtimisht, keni vetëm 15 minuta kohë për të paraqitur platformën tuaj.

Gëzim Podgorica – Ju përshëndes dhe ju uroj mbarësi!

Radiotelevizioni public, për hir të së vërtetës, ka bërë një hov të fuqishëm gjatë këtyre viteve, ka ndaluar rënien që ka pasur dhe ka filluar një ngritje, e cila, në gjykimin tim, ka marrë kredite të admirueshme te publiku. Mendoj se Këshilli Drejtues duhet ta inkurajojë ecurinë pozitive të RTSH-së, pra të kësaj ecjeje dhe domosdoshmërisht duhet ta mbështesë, me qëllim që kreditet publike të realizuara deri tani të avancohen edhe më shumë.

Mbështetur në përvojën time të gjatë në shtyp, meqenëse unë kam drejtuar disa institucione medietike, si Agjencinë Telegrafike Shqiptare, Radio Tiranën dhe institucione të tjera, mendoj se mundësitë e Këshillit Drejtues për të inkurajuar një zhvillim të mëtejshëm të RTSH-së, sigurisht, brenda të gjitha atyre kompetencave që ka Këshilli Drejtues, duhet të administrohen sa më pozitivisht.

Më falni, sepse jashtë modestisë mund t'ju them se në përvojën time, kur kam qenë drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Telegrafike Shqiptare, i kam kushtuar shumë vëmendje marrëdhënies me të huajt dhe me institucionet homologe. Vetëm përfshirja e Agjencisë Telegrafike Shqiptare në një platformë medietike, në të cilën merrnin pjesë 57 agjenci nga e gjithë bota, krijoi akses që komunikimi dhe evidentimi i Shqipërisë në të gjitha vendet ishte shumë më i mundur dhe me impakt shumë pozitiv. Mbështetur mbi këtë përvojë, mendoj se do të jetë shumë mirë që RTSH-ja ta intensifikojë gjithnjë e më tepër të gjithë këtë veprimtari në marrëdhënien me partnerët e huaj. Ne e dimë që RTSH-ja është pjesë e EBU-së dhe ka marrëveshje shumë të rëndësishme efektive, por Këshilli Drejtues mendoj se duhet të intensifikohet dhe ta inkurajojë këtë bashkëpunim.

Pika ku mendoj se duhet të fokusohet Këshilli i ri Drejtues është marrëdhënia më efektive dhe më dinamike me Kuvendin e Shqipërisë. Në mënyrë të veçantë Kuvendi duhet të forcojë rolin e tij nëpërmjet kryetarit, por edhe anëtarëve të tjerë të Këshillit Drejtues. Sigurisht, kryetari në këtë rast ka një rol dhe një përgjegjësi më të madhe, jo vetëm si drejtues, por edhe në pozicionin e tij, sepse besoj se figura që ju do të zgjidhni do të jetë e tillë që do ta luajë një rol shumë efektiv.

Po kështu, në gjykimin tim, Këshilli Drejtues duhet të inkurajojë dhe të nxisë një debat lidhur me projekte të rëndësishme artistike dhe debat më të madh politik. Sot RTSH-ja ka emisione politike, ka edhe misione kulturore, por ato nuk janë në atë nivel që të tërheqin audiencën në atë shkallë sa të jenë konkurrencte me televizionet e tjera, flas për 2 apo 3 televizionet më të mëdha në vend. Normalisht që realizimi i programeve me impakt të madh publik në RTSH, po kështu edhe i debatit politik kërkojnë edhe një relaksim të marrëdhënieve financiare dhe të një hapësire më të interpretueshme, me qëllim që të këtë suport edhe nga ana financiare për të tërhequr personazhe të rëndësishme të fushës së medias. Lidhur me këtë, unë mendoj se pagat duhet të jenë stimuluese për këto personazhe të medias që mund të vijnë dhe të drejtojnë këto emisione, por asnjëherë nuk jam që paga e tyre të kalojë pagën e drejtorit të Përgjithshëm. Gjithmonë e kam konsideruar nonsens jo vetëm brenda sistemit të radiotelevizionit, por brenda çdo sistemi që pagat duhet të jenë të arsyeshme. Normalisht që tregu është i hapur, mediet private ofrojnë shumë më tepër, por mediet, siç është rasti i RTSH-së apo institucione të tjera, duhet të këtë një baraspeshë dhe nuk duhet të kenë një diferencë të tillë, e cila prish edhe sistemin e pagave në vendin tonë, megjithatë këto mbeten pjesë e një diskutimi, pjesë e një debati, pjesë e asaj që përfshin edhe ligji dhe asaj çka ofron ligji i RTSH-së, por edhe përgjegjësitë që ka Këshilli Drejtues.

Ky këshill duhet të kthehet në një arenë të debatit midis anëtarëve të tij, por edhe të këshillit artistik që ka. Përgjegjësia duhet të jetë e tillë që ky debat të nxisë dhe të çojë përpara të gjithë atë strukturë artistike që është e nevojshme t'i serviret publikut.

Sigurisht që roli i këshillit drejtues është i limituar në një lloj kuptimi në disa nene që janë aprovuar nga Kuvendi, por mundësia e tij për të inkurajuar dhe për të nxitur debat, për ta kthyer atë në pjesë të një diskutimi shumë të rëndësishëm, jo vetëm për strukturën organizative ose për projekte që lidhen me financat, por, mbi të gjitha, me projekte që lidhen me avancimin artistik, avancimin e emisioneve dhe të strukturës është pjesë kryesore dhe integrale e kësaj pune.

Lidhur me cilësorin “publik”, rikonfirmoj edhe një herë në gjykimin tim se RTSH-ja tashmë e meriton cilësorin publik, nuk them se ka arritur majat, absolutisht jo, por hapat kanë qenë të kujdesshëm, seriozë dhe, nëse ruhet kjo performancë në ngjitje, besoj se RTSH-ja do të jetë pjesë e një media shumë serioze brenda EDU-së. Këto janë disa nga idetë e mia.

Ramazan Gjuzi– Faleminderit, zoti Podgorica!

A ka pyetje nga anëtarët e komisionit? Nuk ka.

Faleminderit, zoti Podgorica!

Kalojmë te kandidati tjetër, zotin Gaspër Marku.

Gasper Marku – Përshëndetje!

Kam një përvojë 40-vjeçare në fushën mediatike në të gjitha gjinitë mediatike, në radio, televizion, në median e shkruar, pra gjithë këto vite kam pasur një aktivitet të dendur mediatik.

Fillimet e mia kanë qenë me Radio Shkodrën dhe me RTSH-në. Në vazhdimësi bashkëpunimet kanë qenë jo të pakta edhe me televizionet kombëtare, private dhe lokale. Gjithashtu, kam bashkëpunuar edhe me të gjitha gazetat e shkruara kombëtare, pa llogaritur një përvojë të gjerë në mediat lokale, sidomos me Radio Shkodrën dhe mediat e tjera lokale.

Me hapjen e stacioneve private televizive në Shkodër, unë kam pasur rastin të jem ndër themeluesit e stacionit të parë televiziv në Shkodër dhe qysh nga viti 1996 dhe në vazhdim unë vazhdoj të jem pjesë aktive e këtyre mediave, madje për disa vjet kam qenë edhe drejtues i TV Rozafa, një përvojë që më ka shërbyer edhe më tepër të jem pranë kësaj fushe.

Kam qenë korrespondent i ATSH-së për Qarkun Shkodër dhe kjo përvojë ka qenë pa dyshim shumë pozitive në trajtimin e të gjitha rubrikave që përmban në një qark.

Përpos kësaj, kam pasur rastin të jem zëdhënës i bashkisë së Shkodrës për 8 vjet...*(nuk dëgjohet)*

Aktualisht jam pjesë e programicionit në Radio Shkodra, që po përgatitet të dalë në platformën dixhitale të transmetimit, RTSH Shkodra.

Ndërkohë, mbaj një post prej disa vitesh, jam kryetar i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë të Qarkut Shkodër, ku jam përpjekur të jap kontributin tim, duke vijuar të trajtojmë edhe shumë aktivitete mediatike në bashkëpunim me Unionin Qendror dhe mendoj se kemi bërë gjëra jo të vogla. Sidomos, Dega Shkodër ka meritën e veçantë se ka themeluar çmimin e gazetarëve “Hamit Boriçi” kësaj embleme të gazetarisë shqiptare që personalisht kam kënaqësinë që jam unë ai që e kam propozuar dhe themeluar, duke pasur kënaqësinë të nderoj dhe t’ia shpërblejmë ato kontribute dhe ato bashkëpunime, ku vetë profesor Boriçi ka dhënë për ne gazetarët dhe kryesisht edhe për mua.

Pak a shumë kjo është një panoramë e përgjithshme e veprimtarisë sime (*shkëputje*)... jo vetëm në RTSH Shkodra, por edhe në rrjetet sociale, ku drejtoj një portal në Veri që më tepër i përket fushës së sportit, pa llogaritur edhe sektorë të tjerë, fusha e sportit është një ndër pasionet e mia të hershme, ku jap një kontribut jo të vogël, jo vetëm në kuadrin lokal, por edhe atë kombëtar në të gjithë trajtimin e problematikave në Shkodër dhe në Shqipëri.

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Marku!

Ftoj anëtarët e komisionit t’i drejtojnë pyetje zotit Marku.

Urdhëroni, zoti Papa!

Kristaq Papa – Përshëndetje!

Doja të dëgjoja nga kandidati për projekte për ngritjen cilësore të televizionit. Dakord, dëgjuam përvojat e tij, por këtu e kemi thirrur për të dëgjuar mundësitë, projektet, programet për të ndryshuar cilësinë e RTSH-së, për ta ngritur, për ta nxjerrë nga gjendja në të cilën ndodhet, për ta bërë prodhimtar, për ta bërë të shfrytëzueshëm, për ta bërë që t’i japë para buxhetit të shtetit dhe jo t’i marrë.

Pra, kemi nevojë të dëgjojmë idetë dhe projektet tuaja, jashtë CV-së suaj.

Faleminderit!

Gaspër Marku - Faleminderit!

Unë mendoj që fillimisht do të ishte me interes të përcillja një vlerësim pozitiv për punën aktuale të viteve të fundit të RTSH-së, sepse është krejt ndryshe, jo vetëm mendimi im personal, por edhe i kolegëve të mi në Shkodër dhe në mbarë Shqipërinë, sepse kontaktet i kemi të afërta me të gjithë me anëtarët e Unionit të Gazetarëve (*Nuk dëgjohet*) të gjithë janë të mendimit se

RTSH-ja ka ndryshuar tërësisht në programacion, në performancë me një afrimitet jo të vogël me publikun *(Nuk dëgjohet)*

Kjo dallohet qartë jo vetëm në edicionet informative, por edhe në emisionet *(shkëputje)*... qoftë politike, kulturore apo sportive *(Nuk dëgjohet)*

Në vazhdimësi mund të bëhet edhe më mirë, sipas mendimit tim dhe duke pasur përvojat e mia të kahershme, si dhe një afrimitet me programacionet e kulturës dhe të sportit jam i mendimit që tek sporti do të ishte diçka shumë interesante, jo se nuk është në prioritetin e RTSH-së, por mendoj se duhet gjetur një gjuhë bashkëpunim, një komunikim me Federatën Shqiptare të Futbollit, të gjendet edhe gjuha e përbashkët me ta. Duhet ta pranojmë se kategoria superiore e futbollit shqiptar është ajo që është më e ndjeshmja në publik dhe këtë transmetim të kësaj kategorie, RTSH-ja nuk e ka për momentin, edhe pse tentativat kanë qenë të shpeshta. Dakord, transmeton kategorinë e parë, se ka shumë interes, transmeton lojërat me dorë, peshëngritjen, atletikën, sporte të ndryshme, transmeton edhe sportet e huaja, por duke qenë në kontakt të vazhdueshëm dhe shumë të afërt me publikun *(Nuk dëgjohet)*

Për ta bërë RTSH-në edhe më të afërt për publikun, jo se nuk është, por bën hapa shumë përpara, por ky mund të jetë ai hapi, mund të jetë goli, që themi në gjuhën sportive... *Nuk dëgjohet)*

Kam mendimin se çdo ditë duhet të ketë një emision të posaçëm sportiv, se ka mjaft emisione që transmetohen nga kolegët tanë *(Nuk dëgjohet)* duhet të jetë çdo ditë i përcaktuar një orar i përshtatshëm për ta thithur publikun në një edicion sportiv, me lajme të vendit dhe të huaja, pra të jetë një formë ndryshe nga ato emisionet e analizave, që janë 2-3 herë në javë. Mendoj se kjo mund të jetë diçka e veçantë dhe e ndjeshme, krahas emisioneve të tjera kulturore. Po flas vetëm për sektorin sportiv, ngaqë unë jam shumë i afërt me këtë fushë dhe mendoj se kjo i jep më tepër progres në nivelin e komunikimit dhe të bashkëpunimit me publikun... *(Nuk dëgjohet)*... financiarë të këshillit drejtues, përmirësimi i tyre, por këto janë anë teknike që çdo këshill i ka në vëmendje, por unë u ndala te ky moment, që është një moment i prekshëm dhe aktual. Këtu përcjell edhe zërin, mendimin, propozimin dëshirën e një publiku të gjërë që superiorja e futbollit shqiptar të ndiqet në kanal RTSH-së, sepse është elementi më i afërt, nuk dua të ripërsëris vlerat që ka, por nëse realizohet një gjë e tillë, atëherë do të ishte diçka fantastike për të gjithë shikuesit e stacionit publik shqiptar.

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Marku!

A ka ndonjë pyetje tjetër? Nuk ka.

Atëherë, kalojmë në prezantimin e kandidatit të radhës.

Përshëndetje, zoti Krisafi!

Ksenofon Krisafi – Përshëndetje edhe juve!

Ramazan Gjuzi – Fjala për ju për të paraqitur platformën tuaj. Keni 15 minuta kohë.

Faleminderit!

Ksenofon Krisafi – Edhe unë ju falënderoj!

Është kënaqësi të prezantoj një platformë për sa u përket veprimtarive, ndërhyrjeve eventuale, reformave të vazhdueshme në Radiotelevizionin Shqiptar.

Përpara se të them se çfarë mendoj se duhet bërë në Radiotelevizionin Shqiptar për të axhustuar ndonjë gjë që shikohet e arsyeshme sipas mendimit tim, do të doja të prezantoja veten shumë shkurtimisht.

Marr kurajën të konkurroj për postin e kryetarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së, duke ardhur nga një veprimtari e gjerë akademike, administrative e diplomatike. Kam qenë pedagog, dekan, zëvendësrektor, president i Akademisë Shqiptare të Arteve dhe të Shkencave, mbaj titullin “*Doktor Honoris Causa*” në universitetin *Sancti Cyrilli të Valetës*, “*Ambasadore, grand academico imperiale d’Albania*”, akorduar nga Akademia Imperiale e Romës. Jam autor dhe bashkautor i 28 librave dhe disa dhjetëra artikujve shkencorë, pjesëmarrës në rreth 60 konferenca me karakter shkencor brenda dhe jashtë vendit. Kam një veprimtari të pasur administrative, duke ecur në shkallë të ndryshme nga nëpunës, shef Sektori, drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme, sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, anëtar i Komisionit të Letrave me Vlerë dhe drejtor Ekzekutiv i tij, dekan në fakultet, zëvendësrektor në universitet, si dhe një veprimtari të pasur dhe interesante diplomatike që fillon nga shërbimi diplomatik në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ku kam pasur postin e drejtorit të Drejtorisë Juridike Konsullore dhe Traktateve Ndërkombëtare. Më pas kam qenë ambasador në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në degën e saj në Gjeneve, në Organizatën Botërore të Tregtisë, në disa organizata të tjera ndërkombëtare me seli në Gjeneve, pjesëmarrës në organet drejtuese të disa organizatave ndërkombëtare, pjesëmarrës në mbi 100 konferenca ndërkombëtar me karakter politik, ekonomik, shëndetësor, kulturor e të tjera në qytete të ndryshme në vende të ndryshme.

Dua t’ju garantoj se nuk kam asnjë problem moral, politik apo juridik që të atakojë legjislacionin apo kërkesat institucionale që vijnë nga akte të ndryshme të vendit tonë.

Guximin për të konkurruar për postin e kryetarit të Këshillit Drejtues e kam konsideruar një sfidë tjetër që vjen pas një përvoje të gjatë pune, veprimtarie në sektorë të ndryshëm, me qëllim që së bashku me kolegët që janë anëtarë të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit, por edhe punonjës të tjerë, drejtori i Përgjithshëm, zëvendës drejtori i Përgjithshëm, që do të jenë eventualisht bashkëpunëtorë potencialë, të jap kontributet e mia modeste në dobi të zhvillimit dhe modernizimit të këtij institucioni me rëndësi të veçantë kombëtare.

Çfarë do të bëhet?! Kjo është pyetja që shtrohet konkretisht në këtë rast. Natyrisht që nuk është e lehtë për cilindo që nuk është marrë për një kohë të gjatë me një institucion specifik dhe me rëndësi të veçantë, siç është Radiotelevizioni, të pretendoj të filloj të shtjelloj me një vështrim nga jashtë, me një platformë reformash dhe ndërhyrjesh në strukturat drejtuese, administrative, si dhe në funksionet, kompetencat dhe veprimtaritë e tyre.

Unë kam mendimin që, me aq sa e njoh situatën, gjendja aktuale në Radiotelevizionin Shqiptar është e mirë dhe është rezultat i një pune më shumë se gjysmë shekullore të disa qindra dhe mijëra njerëzve me vlera dhe aftësi të spikatura që kanë punuar dhe kanë drejtuar në këtë institucion. Është rezultat i përvojave pozitive të grumbulluara nga radiotelevizionet në vendet e tjera, ku këta njerëz të angazhuar në Radiotelevizionin Shqiptar, ose që kanë qenë të angazhuar, kanë përfituar nga përvojat e tyre. Situata, siç e thashë, nuk mund qortohet, përkundrazi duhet të vlerësohen transformimet e rëndësishme dhe rezultatet shumë të mira të deritanishme.

Mendoj se në Radiotelevizionin Shqiptar janë realizuar ndryshime të rëndësishme, të cilat kanë ardhur si rezultat i reformave të ndryshme që janë ndërmarrë dhe gjykoj se ka vend që të konsolidohen më tej, me qëllim që Radiotelevizioni, ky institucion kaq shumë i dashur për shqiptarët, të vazhdojë të ecë drejt progresit, zhvillimit dhe përmirësimeve si çdo institucion tjetër.

Mendoj se ai që do të jetë në krye të Këshillit Drejtues e ka për detyrë të bëhet furnizues i ideve novatore dhe interpret i vullnetit për zhvillimin e të gjithë sektorëve dhe strukturave drejtuese, operative të Radiotelevizionit Shqiptar, duke filluar nga Këshilli Drejtues, nga drejtori i Përgjithshëm, bordi i administrimit, punonjësit, artistët, si dhe të gjithë të tjerët që janë në detyrë në këtë institucion të rëndësishëm.

Synimi duhet të jetë perfeksionimi i performancës së të gjitha hallkave strukturore të Radiotelevizionit, me qëllim që secila të ketë pavarësinë e saj ligjore, këtë e theksoj që Radiotelevizioni Shqiptar duhet të jetë radiotelevizion publik, duhet të jetë një radiotelevizion i

pavarur dhe këtë e realizon nëse ai do të sigurojë pavarësinë e strukturave të tij. Sa më të saktësuara, të zyrtarizuara juridikisht të jenë fushat e veprimtarisë, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e gjithsecilit, duke përfshirë edhe sektorët përkatës, drejtoritë, departamentet, njësitë e të tjera, aq më e garantuar do të jetë edhe pavarësia e tyre. Kjo kërkon rishikimin, përshtatjen dhe eventualisht plotësimin e legjislacionit që rregullon statusin dhe veprimtarinë e Radiotelevizionit Shqiptar.

Gjykoj se është mirë që ajo të vazhdojë të bëhet, duke respektuar konfigurimin administrativ dhe strukturor aktual të radiotelevizionit, konfigurim ky që ngjason me një shtet në miniaturë, sepse radiotelevizioni ka avantazhin dhe privilegjin të veprojë duke pasur 3 pushtete. Atë legjislativ që është Këshilli Drejtues me kompetenca të gjera dhe të rëndësishme në trajtimin e të gjithë veprimtarisë së Radiotelevizionit, që i realizon nëpërmjet bashkëpunimit me organet e tjera, siç është Bordi i Administrimit. Ka ekzekutivin që janë drejtori i Përgjithshëm, zëvendës drejtori i Përgjithshëm dhe hallkat e tjera të rëndësishme. Ka edhe gjyqësorin në kuptimin figurativ të fjalës, i cili përbëhet nga Këshilli për Shikuesit dhe Dëgjuesit, që ka rëndësi të veçantë dhe ka nevojë sipas mendimit tim të aktivizohet më tej, me qëllim që fjala, veprimtaria e tij të jetë më efikase.

(Nuk dëgjohet.)...në kuptimin figurativ të fjalës kanë si qëllim të realizojnë shërbime cilësore në sektorin e televizionit për të informuar, për të edukuar, për të argëtuar publikun, duke u shërbyer të gjitha grupeve të shoqërisë shqiptare, duke mos lënë mënjanë pakicat kombëtare, shtresat e marginalizuara, fëmijët, njerëzit me interesa të tjera e të tjera, pa përjashtuar interesat kombëtare.

Unë mendoj se reforma e Radiotelevizionit Shqiptar duhet të jetë e vazhdueshme jo në kuptimin e rëndomtë të fjalës, por të nevojës për ndryshim, për përmirësim, për përsosje, për sanksionimin e arritur dhe për një hapje të mëtejshme të vizionit për të ardhmen sa më të mirë të këtij institucioni. Kjo mënyrë avancimi që unë e përdor, nuk e them t vetëm në kuptimin e zhargonit, por është një metodë racionale dhe shumë efikase. E tillë ka rezultuar në vende të tjera të tilla të rëndësishme, si Franca, Italia, Gjermania, Belgjika, të cilat kam pasur rastin t'i hetoj, të interesohem, ku çdo 4-5 vjet kam vënë re se ka lëvizje, ndryshime, miratime të ligjeve, të akteve të tjera apo përmirësime, plotësime, reformimet përkatëse...

Reformën nuk mund ta bëjmë dot me fjalë, me llafë të njerëzve, por ajo bëhet me akte ligjore, akte rregullatore, me ndërhyrje në legjislacion, jo vetëm në legjislacionin e përgjithshëm,

që është kompetencë e Kuvendnit, por edhe e legjislacionit që është kompetencë e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.

Nëpërmjet këtyre akteve duhet të synohet që të vendosen kritere të forta për të përcaktuar raporte të drejta midis pjesës menaxheriale, administrative dhe pjesës krijuese, artistike, gjithmonë në drejtim të thellimit të pavarësisë krijuese të këtyre hallkave, të pavarësisë editoriale, të pavarësisë financiare të hallkave dhe të institucioneve në përgjithësi. Në këtë mënyrë do të arrihej në rritjen e besueshmërisë dhe të nivelit artistik, në rritjen e audiencës dhe ndikimit në publik, rrjedhimisht në rritjen e karakterit dhe të rolit publik të Radiotelevizionit, në përcaktimin e kritereve të sakta të konkurrimit artistik dhe administrativ, në konkurrimin me anën e projekteve artistike, duke siguruar transparencën, një element shumë i domosdoshëm për ta shëndoshur dhe për ta çliruar çdo institucion nga ndërhyrjet e padrejta.

Në këtë mënyrë... *(nuk dëgjohet.)* duke rekrutuar personel cilësor dhe duke u nisur nga vlerësimi i performancës së tyre profesionale dhe artistike do të arrihet që Radiotelevizioni t'u përshtatet niveleve në të cilat është në përgjithësi shoqëria shqiptare. Me këtë nuk dua të them se ai nuk është i përshtatur me këto nivele, që ai është mënjane këtyre niveleve, absolutisht jo, mendimi im është krejt i kundërti, është shumë pozitiv për të, por kjo është një nevojë e domosdoshme e zhvillimit në përgjithësi dhe jo vetëm e Radiotelevizionit Shqiptar. Siç e thashë kjo realizohet duke i sanksionuar në rregullore.

Një drejtim tjetër i veprimtarive reformuese do të ishte, sipas mendimit tim, vënia në eficiencë e organeve këshilluese, veçanërisht Këshillit të Shikuesve dhe të Dëgjuesve, Bordit të Administrimit e të tjera.

Synimi kryesor në këto reforma do të ishte përcaktimi i saktë i detyrave, i funksioneve dhe i kompetencave të secilit prej këtyre organeve, me qëllim që të mos ketë mbivendosje midis tyre që secili të bëjë punën që i takon, pa e ndërlikuar veprimtarinë të tjerëve.

Këshilli Drejtues duhet të luajë rolin e tij legjislativ dhe atë sa i takon dhe rolin kontrollues, me qëllim që të mos u lerë mundësi dhe hapësirë ndërhyrjeve individuale subjektive nga individë të caktuar, por gjithçka të funksionojë, të rregullohet, të administrohet mbi baza të përcaktuara që janë të fiksuara në rregullore, në ligje me akte, në statutin e Radiotelevizionit apo në akte të tjera që trajtojnë, rregullojnë dhe menaxhojnë burimet njerëzore apo financiare, forcat krijuese dhe punonjësit në përgjithësi.

Duke vepruar në këtë mënyrë, sipas mendimit tim, duke e rregulluar nëpërmjet akteve juridike, mund të disiplinohet më mirë tërheqja e institucionalizuar e mendimit të publikut me anë të anketimeve, me anë të audiencave, për të identifikuar preferencat e tyre për sa i përket emisioneve apo programeve që ata kërkojnë nga ana e Radiotelevizionit Shqiptar.

Unë mendoj se këshilli duhet të inkurajojë publikimin e menjëhershëm të të gjitha akteve normative vendimmarrëse, si dhe respektimin e kërkesave formale juridike, afateve procedurale, disiplinës administrative e të tjera, që të mos lejojë vakume dhe të mos veprohet pa u ndikuar, pa respektuar dhe pa zbatuar vendimet që janë marrë prej tij dhe prej hallkave të tjera të Radiotelevizionit. Kjo merr rëndësi të veçantë sidomos për përmbushjen në kohë të të gjitha angazhimeve që burojnë veçanërisht nga aktet me karakter financiar, të cilat doemos hyjnë në kompetencat e këshillit ose në kompetencat e organeve të tjera. Me këtë rast, kryetari dhe këshilli duhet të tregohen të vëmendshëm, që bashkëveprim edhe me strukturat e tjera, të garantojnë që financimet nga buxheti i shtetit të shpenzohen sipas zërave të parashikuara në buxhetin e institucionit, me qëllim që të mos krijohen disbalanca dhe probleme.

Drejtim tjetër i rëndësishëm i veprimtarisë së këshillit, sipas meje, janë edhe marrëdhëniet institucionale të Radiotelevizionit Shqiptar me institucionet homologe në shtete të tjera, si dhe me organizma të tjera ndërkombëtare, veçanërisht me BE-në.

Radiotelevizioni Shqiptar, siç më rezulton, ka marrëdhënie shumë interesante, shumë të mira dhe shumë dobiprurëse me mjaft radiotelevizione homologe në vende të tjera të botës, ka gjithashtu pjesëmarrje aktive në organizata të ndryshme ndërkombëtare të fushës së tij, të cilat janë të rregulluara nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare. Duhet që këto lloj marrëveshjesh të jenë më efikase, të jenë më në qendër të vëmendjes së këshillit e të organeve të tjera të Radiotelevizionit, me qëllim që të përfitohet maksimalisht nga mundësitë e krijuara prej tyre.

Sipas meje, këshilli duhet të tregohet më aktiv, për të pasur më të pranishme në ekranet e kanaleve të ndryshme të Radiotelevizionit Shqiptar çështje që kanë të bëjnë me anëtarësimin e pritshëm të Shqipërisë në BE. Ky është një angazhim goxha i rëndësishëm, që kërkon edhe një përgatitje paraprake të opinionit të gjerë. Më mirë nga ç' mund ta bëjë Radiotelevizioni, nuk e bën dot askush tjetër, sepse ai ka përqasje goxha të madhe.

Në këtë kuadër, Radiotelevizioni Shqiptar duhet të punojë më shumë, ndoshta edhe më mirë, për sa i përket përqasjes së mëtejshme të legjisllacionit shqiptar në fushën e tij, me direktivat përkatëse të Bashkimit Europian e të konventave ndërkombëtare.

Një detyrim tjetër funksional i kryetarit dhe i këshillit, është të mbikëqyrë paanshmërinë, objektivitetin dhe tërë gjithanshmërinë e informacionit audioviziv, që Radiotelevizioni Shqiptar të garantojë atë që i ka caktuar ligji: të jetë një institucion publik, të jetë një institucion në shërbim të të gjithë qytetarëve, si dhe të shmangë ndikimet partiake, politike apo ndikimet nga grupe të caktuara të interesit.

Ramazan Gjuzi – Zoti Krisafi, shkurtimisht! Mbaruat? Ju faleminderit, atëherë!

Epo mirë, vazhdoni!

Ksenofon Krisafi – Një tjetër drejtim i veprimtarisë së Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar do të ishte përshtatja me e mirë dhe më adekuate me parimet e të drejtës së autorit dhe të*(nuk dëgjohet)* Radiotelevizionit.

Po ashtu, një tjetër do të ishte që Radiotelevizioni dhe hallkat e tij do të duhet të mendojnë e të përgatiten që, në të ardhmen, të përballojnë pasojat e hyrjes eventuale të aktorëve të fuqishëm audiovizualë të huaj, të cilët mund të konkurrojnë veprimtarinë e Radiotelevizioni Shqiptar. Unë mendoj se mund të punohet në sektorin e dokumentacionit, në atë të arkivit, veçanërisht për përsheptimin e ritmeve të punës për dixhitalizimin e materialeve arkivore.

Nëse do të më jepet mundësia për të kryesuar Këshillin Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar, jam i sigurt se nuk do të gjendem dhe nuk do të veproj në një vakum as institucional, as juridik dhe as njerëzor. Përkundrazi, unë mendoj se në Radiotelevizionin Shqiptar është punuar mjaft mirë, kanë ndodhur transformime të rëndësishme, ka pasur zhvillime progresive, janë realizuar arritje të pamohueshme, dhe Radiotelevizioni Shqiptar i sotëm nuk ka krahasim me atë që ishte dhjetë vjet më parë, le të themi.

Ndryshimet e ndodhura fillojnë nga filozofia konceptuale, fillojnë nga politikat e veprimtarisë së përditshme, nga ato perspektive, nga legjislacioni që rregullon veprimtarinë e tij, nga drejtimi, administrimi, personeli, buxheti, investimet e të tjera.

Një faktor tjetër pozitiv, që do ta lehtësonte punën e cilitdo që do të ndodhej në krye të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar, është ekzistenca e një grupi personalitetesh të spikatura, si anëtarë të këshillit drejtues, puna me të cilët do të qe privilegj për këdo.

Nuk mund të lihet pa përmendur fakti që sot Radiotelevizioni Shqiptar ka një drejtim bashkëkohor, të frymëzuar nga modele të përparuara, që vijnë nga përvojat botërore. Unë do të kisha kënaqësinë të përmendja këtu, me konsiderata të veçanta, punën dhe *(Nuk dëgjohet)* të Përgjithshëm, zotit Gëllçi, që sipas mendimit tim, ka sjellë aty *(Nuk dëgjohet)* Radiotelevizionit

Shqiptar është pjesë e një rrjeti shumë të gjerë e të fuqishëm bashkëpunimi ndërkombëtar, siç e përmenda.

Të gjitha këto janë një pikënisje e shëndoshë për zhvillime të tjera, dhe natyrisht, janë avantazhe për cilindo që do të mund të marrë postin e kryetarit të Këshillit Drejtues.

Ramazan Gjuzi – Ju faleminderit, zoti Krisafi!

Fjala për anëtarët e komisionit.

Po, zoti Beqiraj!

Ismet Beqiraj – Përshëndetje!

E dëgjova me shumë vëmendje profesorin.

Në radhë të parë, profesor, ju falënderoj për kontributin që jepni edhe duke marrë pjesë në këtë konkurrim.... *(nuk dëgjohet)* për televizionin që duam.

Unë do të ndalesha vetëm në një nga drejtimit që ju keni në punën tuaj, lidhur me synimet e pavarësisë së RTSH-së. *(Nuk dëgjohet)*..... lidhur me kontrollin parlamentar.

Ramazan Gjuzi – Zoti Beqiraj, nuk dëgjohehi!

Ismet Beqiraj – Urdhëro!

Ramazan Gjuzi – Po. Tashti po.

Ismet Beqiraj – Po, të dëgjoj.

Pra, nuk u dëgjova fare në fillim?

Ramazan Gjuzi – Kishe shkëputje, zoti Beqiraj!

Ismet Beqiraj – Ah, nuk e di. Tani, jam në rregull?

Ramazan Gjuzi – Po.

Ismet Beqiraj – Pra, po flasim për paraqitjen që bëri. Është nder e respekt edhe për këtë komision, jo vetëm për eksperiencën e gjatë, nivelin e tij intelektual dhe kontributin që ka dhënë për shumë vite, po edhe për paraqitjen e qartë të asaj çfarë i duhet RTSH-së, dhe më drejt, çfarë i duhet drejtimit të Këshillit Drejtues të RTSH-së, vetëm një nga synimet e platformës së tij, që paraqiti mbi pavarësinë e RTSH-së.

RTSH-ja është një institucion i pavarur publik, edhe me ligj tashmë. Unë doja të dija që, përveç plotësimin të legjislacionit, që ju kërkoni, cilat do të jenë shtyllat e pavarësisë të këtij institucioni, në mënyrë që ta bëjmë më dinamik, në kushtet e ekonomisë së tregut e të konkurrencës?

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Beqiraj!

Fjala për ju, zoti Krisafi!

Po, zoti Papa!

Kostaq Papa – Faleminderit, kryetar!

E dëgjuam kandidatin e nderuar, të cilin unë e kam pasur edhe profesor. Ai u ndal më shumë në aspektin administrativ, të fleksibilitetit të aseteve e të gjendjes që ka Televizioni.

Doja të dija: prezenca e tij si drejtues, çfarë do t’i jepte përparësi Televizionit në produktin e tij, në programet në ekran? Sepse administrimi dhe reforma janë pjesa e padukshme, ose janë pjesa prapa ekranit. Që publiku t’i afrohet dhe t’i rikthehet televizionit, ka nevojë për ekranin, për cilësinë e tij, domethënë për cilësinë e programeve, për shumëllojshmëri e për gjithçka tjetër. Në cilat nga këto aspekte, te programi, do të ndikonte prezenca e profesorit, si drejtues i këtij këshilli?

Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Papa!

Hapeni mikrofonin, zoti Krisafi!

Zonja Kumbaro, mos kishit pyetje?

Ksenofon Krisafi – Dëgjohem?

Ramazan Gjuzi – Një minutë, zoti Krisafi!

Zonja Kumbaro ka një pyetje.

Mirela Kumbaro – Ndoshta kështu zoti Krisafi mund t’i përmbledhë të gjitha pyetjet në një përgjigje të sintetizuar.

Zoti Krisafi, duke qenë se në parashtrësën tuaj përmendët edhe aspektet juridike, dhe besoj aspekti ligjor është ai që ju karakterizon më shumë, sigurisht, pa diskutim që ju e njihni ligjin “Për mediat audiovizive”, një kapitull i veçantë i të cilit ka të bëjë pikërisht me Radiotelevizionin. Cili do të ishte sugjerimi juaj, sipas këndvështrimit tuaj si profesor i së drejtës, çfarë do të duhet të ndryshohej në ligjin “Për mediat audiovizive”, në atë pjesë që i takon Radiotelevizionit Shqiptar, për ta bërë më efikas jo thjesht aktivitetin e Radiotelevizionit, por rolin që vetë Këshilli Drejtues i Radiotelevizionit luan në mirëmenaxhimin e këtij televizioni publik? Kjo është pyetja ime. Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zonja Kumbaro!

Fjala për ju, zoti Krisafi!

Ksenofon Krisafi – Unë ju falënderoj që më dëgjuat! Kërkoj ndjesë, sepse fola shumë shpejt, për të qenë brenda limiteve kohore të përcaktuara nga administrata juaj.

Për sa i përket pyetjes së zotit Papa, në lidhje me programet, doemos që e kam të vështirë të shprehem konkretisht. E vetmja gjë që unë marr përsipër të garantoj, sigurisht në sedo të jem në krye të këtij këshilli, është që të sensibilizoj maksimalisht të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues, të kërkoj mendimin e Drejtorit të Përgjithshëm, zëvendës drejtorit të Përgjithshëm dhe të hallkave të tjera, që të dëgjohen më me vëmendje të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e njëjësive të tjera, të cilët krijojnë, punojnë, mendojnë për eficiencën e Radiotelevizionit Publik Shqiptar.

Është shumë e vështirë të shprehem e të them se do të bëhet ky emision apo ai emision. Gjykoj se do të ishte në interes të një ecurie të mirë dhe moderne të televizionit, që ai të vazhdojë me këtë platformë që ka, në bazë të së cilës mbulon pothuajse të gjitha interesat e shoqërisë shqiptare, madje dhe të kombit shqiptar, mbulon të gjitha interesat e grupeve të ndryshme të kësaj shoqërie, duke përmendur këtu pakicat kombëtare, grupet e marginalizuara, individët e moshës minore e të tjera.

Pra, garantoj që, duke bashkëpunuar më mirë, më institucionalisht, më ngusht me (*ndërprerje incizimi*) do t'u jap atyre të gjitha hapësirat e nevojshme, që idetë e tyre, projektet e tyre, t'i vënë në jetë.

Kjo për sa u përket programeve.

Për sa u përket aspekteve juridike, sërish e kam të vështirë të shprehem konkretisht, po di të them këtë gjë: që, nga vështrimi i legjislacionit italian, i legjislacionit francez, i legjislacionit belg, kam konstatuar që çdo tre, katër apo pesë vjet, bëhen ndërhyrje në legjislacioni përkatës, i cili rregullon veprimtarinë e radiotelevizioneve të këtyre vendeve. Kjo do të thotë se radiotelevizioni, duke qenë kaq shumë i ballafaquar dhe i ekspozuar me publikun, me opinionin në përgjithësi, ka nevojë të jetë gjithmonë i përshtatur me mentalitetet e reja, me konceptet e reja, që përshkruajnë shoqërinë e sotme njerëzore.

Nga kjo pikëpamje, gjykoj se edhe ky kapitulli që i kushtohet Radiotelevizionit Shqiptar, në ligjin përkatës, dhe ndërhyrja e fundit ka qenë në vitin 2016 apo në vitin 2017, në mos gabohem... Urdhëroni!

Mirela Kumbaro – Ligji është i 2013-ës.

Ksenofon Krisafi – Por është ndërhyrë nja dy a tri herë në të, përfshirë edhe një vendim të Gjykatës Kushtetuese. Natyrisht, nuk ka prekur thelbin e ligjit, por them se kjo kohë e kaluar dhe këto zhvillime të mëdha që janë bërë, fakti që tashmë kemi 16-17 kanale televizive, kemi 12 stacione radioje, përfshirë edhe stacionet e radiove lokale, mendoj se kërkon për ta riparë dhe për

ta rikonceptuar një çikë më ndryshe, në përshtatje me këto zhvillime të reja atë kapitull të ligjit që ka të bëjë me Radiotelevizionin Shqiptar.

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Krisafi!

Zoti Ulqini!

Ismet Beqiraj – Zoti kryetar, nuk iu kthye përgjigje pyetjes sime.

Ramazan Gjuzi – Zoti Ulqini.

Musa Ulqini – Faleminderit që më dhatë fjalën, zoti kryetar!

Dua të bëj një koment të shkurtër. Dua ta përgëzoj zotin Krisafi për platformën reformatore që paraqiti, një platformë serioze, që jep garanci për një cilësi tjetër të re të punës së Këshillit Drejtues, nëse zoti Krisafi do të zgjidhet.

Ajo që më bëri përshtypje ishte gjithçka në përputhje me shtyllat se se si funksionon një media publike. Edhe unë besoj se është nder për komisionin tonë që një personalitet, si zoti Krisafi, i cili ka kontribute të shquara në fushën akademike, administrative dhe diplomatike, do të jetë i suksesshëm edhe si drejtues i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar, nëse ai do të zgjidhet. Unë kam pasur fatin ta njoh gjatë jetës sime politike në të tria këto pozicione dhe kam vënë re një personalitet me shumë integritet dhe që ka shënuar sukses në çdo fushë.

Së fundi, e kam ndjekur RTSH si relator që nga viti 1992, me përjashtim të vitit të fundit, që nuk kam qenë relator, dua të them se nga media publike kemi 4 lajme të mira: së pari, media publike shqiptare sot ofron teknologjinë, është në pararojë sa u përket zhvillimeve teknologjike; së dyti, paketa që ofron për publikun shqiptar media publike, kanalet që u përmendën, duke ndërtuar një raport tjetër shumë aktiv dhe pozitiv me publikun; së treti, pavarësia editoriale e RTSH-së, që gjithnjë e më shumë vlerësohet nga ndërkombëtarët dhe, së katërti, për herë të parë kam vënë re se kandidatët, që kandidojnë për Këshillin Drejtues dhe për kryetar të Këshillit Drejtues, janë personalitete të spikatura. Unë mendoj se këto katër lajme të mira i bëjnë nder edhe komisionit tonë.

Urime, zoti Krisafi! Faleminderit që morët guximin të kandidonit për një post të tillë.

Ramazan Gjuzi – Faleminderit!

Zoti Krisafi, a mund t'i jepni përgjigje pyetjes së deputetit Beqiraj?

Ksenofon Krisafi – Kërkoj ndjesë, por nuk e dëgjova pyetjen e zotit Beqiraj.

Ramazan Gjuzi - Zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Para se të bëja pyetjen, unë i bëra një vlerësim kësaj figure që i bën nder RTSH-së. Nuk heq asnjë presje nga vlerësimet që bëri zoti Ulqini për këtë personalitet, zotin Krisafi.

Në platformën tuaj, profesor, ju me të drejtë synoni pavarësinë e RTSH-së, ndërsa RTSH-ja edhe tani është institucion i pavarur, sigurisht me kontroll parlamentar....*(nuk dëgjohet)*...e kësaj pavarësie që ju mendoni, sepse thatë: krijimtarisë së tij administrative, publike, artistike, mediatike. Ky është një institucion i pavarur. Është me interes jo vetëm për ne anëtarët e këtij komisioni, por edhe për publikun që na dëgjon. Faleminderit!

Ramazan Gjuzi - Po, zoti Krisafi.

Ksenofon Krisafi - Unë mendoj se pavarësia e RTSH-së tashmë është një realitet i pakontestueshëm. Nga kjo pikëpamje RTSH-ja e sotme nuk ka ndonjë ndryshim nga kanalet e tjera televizive private, madje mund të themi se është më neutral dhe i pavarur se disa kanale të tjera televizive, sepse, ndërsa tek ato mund të vërehet një lloj anësie në raport me forca të ndryshme politike, këtë gjë nuk e vërejmë te RTSH-ja, përkundrazi duket mjaft neutral dhe mjaft i orientuar te qytetari, te njeriu, dëgjuesi, shikuesi se te forcat politike. Unë jam i sigurt që nuk mungojnë tentativat që forca të caktuara politike ta përdorin edhe RTSH-në për qëllimet e tyre, që nuk janë qëllime të mbrapshta, nuk mund ta themi që janë qëllime që nuk i shërbejnë zhvillimit dhe Shqipërisë, të gjitha janë parti dhe forca politike në shërbim të shoqërisë shqiptare dhe në interes të progresit të shoqërisë shqiptare, por e mira është që ky institucion të vazhdojë të qëndrojë fort në këtë shtyllë të rëndësishme, që është pavarësia e tij. Pavarësia realizohet nëpërmjet transparencës së institucioneve përkatëse, që formojnë hallkat drejtuese të RTSH-së, duke filluar nga Këshilli Drejtues, Bordi i Administrimit, Drejtori i Përgjithshëm dhe hallkat e tjera.

Gjykimi im sa u përket aspekteve formale juridike problemet e pavarësisë janë tashmë të trajtuara dhe të realizuara ashtu siç duhet në legjislacion. Ajo që kërkohet është që drejtuesit e RTSH-së të bëjnë kujdes që të mos bien pre e tentativave ose përpjekjeve për të ndërhyrë në veprimtarinë e tyre, që mund të cenojnë pikërisht këtë aspekt të veçantë, që mund ta quaj krenaria e veprimtarisë së RTSH-së, pra ruajtja e pavarësisë dhe neutralitetit në raport me forca të caktuara politike.

Ramazan Gjuzi - Faleminderit!

Vazhdojmë me prezantimin e kandidatës së radhës, atë të zonjës Nadja Rusi (Peto).

Fjala për ju.

Nadja Rusi (Peto) – Përshëndetje!

Ju falënderoj për mundësinë për të prezantuar në këtë mbledhje platformën në lidhje me kandidimin tim për kryetar të Këshillit Drejtues të RTSH-së. Unë vij nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës, me eksperiencë si pedagoge e lëndëve të të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, gjithashtu, si dhe si një aktiviste në secilën prej këtyre dy fushave të ekspertizës. Jam doktore e shkencave juridike publike, në çështjet e studimeve gjinore dhe për këtë arsye një nga shtytat e mia për të kandiduar në këtë pozicion ka qenë shtrirja e ekspertizës ose primi i kontributit tim në cilësinë e kryetarit të këtij këshilli, për të përfaqësuar të gjitha interesat e dëgjuesve dhe shikuesve të të gjithave grupeve, kategorive sociale, pavarësisht statusit të tyre, pavarësisht gjendjes ekonomike dhe kategorive ku ata bëjnë pjesë.

Në fakt, vizioni im në lidhje me RTSH-në do të duhej të lidhej në mënyrë të plotë dhe të drejtpërdrejtë me deklaratën e qëllimit të RTSH-së, pra si një media e cila do të duhet të ofrojë transmetimin e shërbimit publik kombëtar, do të duhet të përfaqësojë të gjitha grupet dhe interesat sociale përmes ofrimit të një programacioni, i cili në këndvështrimin tim do të duhet të fokusohet në tri drejtime kryesore:

Së pari, në kuadër të universalitetit, që do të thotë se do të duhet të ishte dhe të jetë një nga parimet dhe shtyllat bazë të veprimtarisë së këtij këshilli në kontekstin e gamës së programacioneve që ai do të duhej të ofrojë. Kjo do të thotë që duhet të jemi të arritshëm dhe të jemi të aksesueshëm për të gjitha kategoritë dhe grupet sociale. Nga ana tjetër, një shtyllë e rëndësishme është diversiteti, që do të thotë diversiteti i shtrirë në tri drejtime kryesore: drejtimin e zhanreve të programeve të ofruara nga RTSH-ja, diversiteti në drejtim të audiencës së targetuar dhe diversiteti në drejtim të tematikave dhe subjekteve të diskutuara në të gjitha programet që ofron RTSH-ja për të arritur një spektër më të gjallë dhe për të mundësuar realizmin e këtyre parimeve në kontekstin e të gjithë sferës së programacionit.

Shtylla e tretë, që unë e konsideroj të rëndësishme për t'u përmendur, do të duhej të ishte patjetër ofrimi i transparencës dhe objektivitetit në kontestin e përmbajtjes së informacionit të transmetuar në çdo moment. Këshilli Drejtues i RTSH-së, në fakt, luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim, sepse është ky këshill i cili miraton programacionin, do të duhet të monitorojë programet që duhet të ofrohen dhe shërbehen nga RTSH-ja.

Në kontekstin e të gjithë veprimtarisë së deritanishme më duhet të theksoj para jush sot se një sërë reformash të ndërmarra në kuadër të digjitalizimit, të cilat janë një arritje për t'u

konsideruar në këtë proces. Nga ana tjetër, në kontekstin e të gjitha këtyre progreseve, që janë bërë deri tani, do të duhet që nën drejtimin e kryetarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së mundet të merren përsipër përgjegjësitë sfidat për të mundësuar jo vetëm ruajtjen e standardit të krijuar, por sidomos për të mundësuar një progres të RTSH-së në frymë dhe në vizion në kuadër të bashkëpunimit dhe marrëdhënieve më të tretët.

Gjithashtu, nëse do të duhet t'i referohemi veprimtarisë aktuale ose statusit aktual në të cilin funksionon RTSH-ja, unë do të thosha që në cilësinë e kryetarit të Këshillit Drejtues do të duhet të ndërmerren hapa në drejtim të atyre elementeve, të cilët nuk kanë arritur mbase të përfundohen deri në këto momente. Flas për një pozicion, i cili po përfundon vetëm për shkak të përfundimit të mandatit, por si pozicion do të duhet që në të gjitha kontekstet të jemi në vazhdueshmëri të drejtimeve dhe të të gjitha elementeve dhe programeve, të cilat mbase deri në këto momente nuk kanë arritur të finalizohen. Kjo do të thotë, se, pavarësisht progresit që është bërë deri tani, ende nuk kemi një strategji 5-vjeçare të përfunduar të RTSH-së, ende nuk kemi një plan biznesi të përfunduar. Kjo do të thotë që, nëse do të duhet të fokusohemi në miratimin e secilit prej këtyre akteve dhe dokumenteve të rëndësishme, për të cilat unë, edhe nga eksperiencia ime në planifikimin strategjik dhe, nga ana tjetër, në pozicionin e juristit pranë Fakultetit të Drejtësisë, mendoj se do të jepja më të mirën time dhe një kontribut të rëndësishëm në përfundimin e secilit prej këtyre dokumenteve strategjike. Kjo do të thotë që në momentin që do të kemi një strategji të tillë afatshkurtër dhe, nga ana tjetër, drejtimet afatgjata të përcaktuara, atëherë edhe vizioni, edhe politikat do të jenë më të mundshme për t'u arritur. Në momentin që ne do të duhet të përcaktojmë një planbiznesi, do të thotë që ne do të detajojmë apo RTSH-ja do të detajojë atë që mbase sot është një nga pikat kyçe dhe më të rëndësishme që referohet në mënyrën e veprimit të këtij institucioni me të tretët, pra sa do të jetë kostoja e minutazheve të transmetimit, si do të mundet të rritim të ardhurat e RTSH-së, në mënyrën e shtimit të fondeve në ndërveprim me të tretët.

Nga ana tjetër, unë do të theksoj një element tjetër të rëndësishëm, që e shoh me interes, bazuar në vetë qëllimin që RTSH-ja ka, që është ofrimi i programeve jo me qëllime ose jo vetëm me qëllime komerciale, unë do të përpiquesha që ,në cilësinë e kryetarit edhe në kontekstin e bashkëveprimit të ngushtë me të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues, sepse jemi në kontekstin një organi kolegjal, kryetari është vetëm një nga anëtarët e Këshillit Drejtues të RTSH-së, i cili do të duhet marrë statusin e rregullimit të të gjithë mënyrës së ndërveprimit të organit dhe përfaqësimit ose ofrimit të një fryme bashkëpunimi dhe vizioni të kryetarit në këtë drejtim, për të pasur një

rishikim të natyrës të programacioneve të ofruara nga RTSH-ja, pikërisht për të përfaqësuar të gjitha kategoritë dhe sidomos grupet vulnerabël. Pra, është i përcaktuar edhe në qëllimet e Radio Televizionit Publik Shqiptar përfaqësimi i pakicave minoritare, përfaqësimi i të gjitha shtresave në nocionin e programacionit dhe transmetimit që ai ofron do të duhet të garantohen, sepse vërtet mund të kemi, edhe në kuadër të projekteve shumë të rëndësishme të ndërmarra deri tani, kanale televizive të hapura, por sfida që shoh në këtë moment është pikërisht programacioni që duhet të ofrojë, sepse programacion do të thotë që do të shtojmë audiencën e Radio Televizionit Publik Shqiptar, programacion do të thotë që ne do të duhet të përfaqësojmë më mirë interesat e dëgjuesve dhe shikuesve të Radio Televizionit Publik Shqiptar dhe, nga ana tjetër, do të thotë më shumë të ardhura për Radio Televizionin Publik Shqiptar.

Gjithashtu, do të doja të theksoja rolin që Këshilli Drejtues i Radio Televizionit Publik Shqiptar do të duhet të ketë në vitet në vazhdim në ndërveprimin e ngushtë me një tjetër këshill të krijuar pranë këtij radio televizioni, që është Këshilli i Dëgjuesve dhe i Shikuesve. Pra, ne do të duhet të krijojmë një lidhje të ngushtë për të mundësuar që interesat e dëgjuesve të dhe shikuesve, të cilat përballen në këshillin përkatës respektiv të Radio Televizionit, të mundet të merren parasysh në kontekstin edhe të Këshillit Drejtues të Radio Televizionit Publik Shqiptar.

Nga ana tjetër, për hir të së vërtetës, është e kotë që ta fsheh para jush edhe një tjetër element që më ka shtyrë të kandidoj në cilësinë e kryetarit të Këshillit Drejtues të Radio Televizionit Publik Shqiptar, që është pikërisht përfaqësimi i drejtë gjinor në të gjitha organet, qofshin ato organe këshillimore, apo organe drejtuese. Pra, do ta shihja me shumë vlerë që posti i kryetarit të mundet të përfaqësohet nga gjinia femërore, për përfaqësimin e interesave të të gjitha grupeve që ajo mbulon dhe përfaqëson edhe me cilësi të tilla të drejtuesit.

Për hir të së vërtetës, në fakt, edhe nëse i referohemi vetë Këshillit Drejtues të Radio Televizionit Publik Shqiptar, të paktën deri tani ka qenë vetëm një anëtare, pra jo vetëm në cilësinë e kryetarit të këshillit, por edhe në cilësinë e anëtarit kemi një disbalancë të theksuar gjinore. Kjo do të thotë se edhe në kuadër të aktivizimit tim të theksuar në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të grave, por edhe të të gjitha grupeve sociale në shoqëri, mendoj se është me shumë vlerë dhe rëndësi që zëri i të dyja gjinive dhe të gjitha interesave të mund të përfaqësohet në çdo nivel drejtimi, në mënyrë që edhe në kontekstin e politikave që ndërmerren, edhe në kontekstin e programeve që ofrohen, edhe në kontekstin e vendimmarrjeve që do të duhet të merren, të kemi një përfaqësim të drejtë gjinor të nevojave të këtyre interesave dhe prioriteteve të veçanta.

Gjithashtu, do të doja të theksoja që në kontekstin e cilësimit tim si anëtare e Bordit Këshillimor të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun, kjo ka qenë një tjetër shtysë imja për t'u përfshirë në këtë pozicion, për të qenë në cilësinë e kryetarit të Këshillit Drejtues të Radio Televizionit Publik Shqiptar. Strategjia për Edukimin Ligjor Publik, në fakt, lë detyra mjaft të rëndësishme dhe ka krijuar shumë sfida për Këshillin Drejtues, pikërisht në kuadër të zbatimit të të gjitha detyrimeve që ofron Strategjia për Edukimin Ligjor Publik. Radio Televizioni Publik Shqiptar është televizioni i duhur, që do të mundet të ofrojë të gjithë informacionin ligjor të nevojshëm për të gjitha grupet sociale jo vetëm në kuadër të ligjeve, por, nga ana tjetër, edhe të të drejtave të grupeve të caktuara. Nëse do t'i referohemi mbrojtjes së të drejtave të individëve me aftësi ndryshe apo kuadrit të të drejtave të çështjeve të grave apo të drejtave të tjera të individëve, do të duhet që këto të reflektohen edhe në kuadër të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun. Ka një ndërhyrje detyrimesh, të cilat duhet të merren në konsideratë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...në kontekstin e të gjitha drejtimeve dhe politikave që do të duhet të ketë Këshilli Drejtues i Radio Televizionit Publik Shqiptar. Ndërkohë, që për të gjitha elementet e tjera që do të duhet të detajohen, patjetër që, nëse do të isha në cilësinë e kryetarit të Këshillit Drejtues, gjëja e parë që do të duhet të bëhet është të shihen të gjitha arritjet që janë bërë deri tani, të shikohet kujemi për të vendosur pikërisht se ku duhet të arrijmë për të realizuar projektin për përmbushjen e objektivave strategjike dhe objektivave specifike të Këshillit Drejtues të Radio Televizionit Publik Shqiptar.

Ju faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit!

Ftoj anëtarët e komisionit t'ju drejtojnë pyetje.

Po, zoti Papa.

Kostaq Papa – Faleminderit, kryetar!

Shoh që gati të gjitha kandidaturat përpiqen, meqë bëhet fjalë për rolin e kryetarit të Këshillit Drejtues, të orientohen tek aspekti administrativ. Mënyra e organizimit dhe administrimit të televizionit është çështja kryesore, por ajo që do ta ngrejë nivelin e Televizionit është aspekti i programacionit dhe i prodhimitarisë së tij. Kështu që, do të doja të dëgjoja nga kandidatja e nderuar diçka lidhur me ndryshimet në programacion, që ajo mund të synojë për të ngritur shikueshmërinë, prodhimitarinë, eficiencën, rritjen e buxhetit, rritjen e cilësisë së punës së gazetarëve, kualifikimin

e tyre dhe gjithçka tjetër, por sidomos në lidhje me prodhimin e programeve të emisioneve, që do t'i ngrenë vlerën financiare dhe do ta barazojnë në treg, për të qenë i konkureshëm.

Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit! Kush ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Fjala për ju, zonja Rusi.

Nadja Rusi (Peto) – Faleminderit, zoti Papa!

Në fakt, e përcaktova si një nga elementet apo shtyllat e vizionit që unë kam për Radio Televizionin apo Këshillin Drejtues, që ishte pikërisht rritja e cilësisë së programacioneve të ofruara, duke përmendur nevojën për një rishikim të programeve të ofruara, nisur nga fakti që është Këshilli Drejtues ai që e miraton programacionin, monitoron cilësinë e programeve të ofruara. Në këtë drejtim, do të synoja që programet e ofruara të preknin një sferë më të gjerë të audiencës dhe, nga ana tjetër, të mendohej për bashkëpunime edhe me subjekte të tjera dhe organizata ndërkombëtare, pikërisht për t'i shtyrë të gjitha këto organizata që programet e tyre apo projektet të mund t'i sjellim pranë Radio Televizionit Publik Shqiptar, në cilësinë edhe të informimit dhe edukimit ligjor të publikut dhe në këtë mënyrë do të synohej rritja e të ardhurave të Radio Televizionit Publik Shqiptar. Pra, për të rritur cilësinë dhe për të mundësuar bashkëpunimin me institucionet dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë, në mënyrë që cilësia e programeve të ofruara në kontekstin e Radio Televizionit Publik Shqiptar të mund të rritej edhe përmes ekspertizës, edhe përmes trajnimeve të ofruara në këto bashkëpunime dhe projekte ndërkombëtare për sa i përket stafit, gazetarëve, anëtarësimit të Radio Televizionit Publik Shqiptar në rrjetet ndërkombëtare të gazetarisë dhe televizionit apo të transmetimeve publike, me qëllim që të mundësonim në të ardhmen sa më të afërt pikërisht një rritje të cilësisë në drejtim të programacionit të ofruar.

Ashtu si me të drejtë e përmendët, edhe unë theksin e vendosa jo në kuadër të mënyrës së menaxhimit dhe organizimit, por pikërisht te cilësia e programacionit të ofruar nga Radio Televizioni Publik Shqiptar. Në cilësinë e kryetarit të Këshillit Drejtues, unë mendoj që mund të ofroj një kontribut mjaft të rëndësishëm për t'i siguruar të gjitha ato elementet që i përmenda në platformën time: universalitetin, diversitetin e programeve për të rritur, pikërisht, shikueshmërinë dhe audiencën.

Ramazan Gjuzi – Ju faleminderit, zonja Rusi!

Po, zoti Ulqini.

Musa Ulqini – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam shumë dëshirë të bëj një sugjerim, duke kërkuar ndjesë nga të gjithë kolegët!

Unë mendoj se është një gjë shumë serioze që kandidatët që vijnë këtu të konkurrojnë, e kanë ndërtuar platformën e tyre, siç është rasti në fjalë. Nadja ofroi një model shumë të mirë, mendoj unë! Kandidatët e kanë ndërtuar platformën e tyre mbi bazën e deklaratës së qëllimit, mbi bazën e kompetencave që ka Këshilli Drejtues, mbi bazën e çfarë parashikon ligji për transmetuesin publik.

Gjithçka që tha zonja Rusi, që lidhet me strategjinë 5-vjeçare, planin e biznesit, me transmetimin, me drejtimin në mënyrë kolegjiale, me programacionin, me audiencën, me raportin me publikun, përmes një reformatimi të Këshillit të dëgjuesve apo shikuesve, me përfaqësimin gjinor, me transmetimet për grupet e marginalizuara e të tjera, janë saktësisht në përputhje me atë që parashikon ligji. Ne nuk mund t'u kërkojmë kandidatëve të bëjnë role, që nuk ua përcakton apo ua kërkon ligji.

Kështu që e mbyll këtë sugjerim, duke komplimentuar maksimalisht pedagogen, zonjën Nadja, për të gjitha çfarë foli këtu, sepse ishte ndërtuar e gjitha mbi atë që kërkohet të jetë platforma e secilit kandidat që konkurren për kryetar të Këshillit Drejtues!

Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Ju faleminderit!

Ju faleminderit, zonja Rusi!

Vazhdojmë me prezantimin e kandidatit të radhës.

Përshëndetje, zoti Bungo!

Njoftoj komisionin që zonja Milena Selimi ka deklaruar që është e sëmure dhe nuk do të japë intervistë për sot.

Kandidati Leka Bungo është i fundit në listën e sotme për prezantimin.

Hapeni mikrofonin, ju lutem!

Fjala për ju, për të bërë prezantimin e platformës suaj. Koha në dispozicion është 15 minuta.

Leka Bungo – Ju faleminderit!

Mund të them në mënyrë telegrafike 2 fjalë për veten time, për t'u prezantuar me anëtarët e komisionit. Kam punuar prej shumë vitesh në fushën e artit dhe të kulturës në krijimtari dhe për shumë vite në radhë, nuk po e them numrin e viteve, pasi janë më shumë seç mendoja, mbi 35 vjet, kam qenë bashkëpunëtor i Radiotelevizionit Publik Shqiptar. Vetëm kohët e fundit, këta 2-3 vjetët

e fundit kam bashkëpunuar dhe kam realizuar dy filma artistikë seriale, një me dy seri, një me tri dhe punë të tjera më të vogla.

Unë aplikova për kryetar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Publik Shqiptar, duke mendua se mund të jap një kontribut për shtyrjen para të këtij gjigandi, që, sipas mendimit tim, ka ngecur në rërë.

Nëse për një sekondë do të bëjmë një krahasim të Radiotelevizionit Shqiptar me televizionet e tjera private, që janë gicat e këtij televizioni, sepse duhet gjykuar se njerëzit më të zotë, gazetarët më të aftë, krijuesit më të talentuar që sot gëlojnë nëpër televizionet private, duke i bërë këto televizione atraktive dhe të ndjekura nga teleshikuesit shqiptarë, kanë qenë krijesa e Televizionit Shqiptar.

Nuk dua të përmend listën dhe inventarin e gjatë të këtyre njerëzve, duke filluar që nga Grabocka, Pali Kuke, Adrian Krasta, Blendi Fevziu e me radhë, këta që sot janë VIP-a të ekraneve në televizionet private, kanë qenë punonjës, krijues dhe gazetarë në Radiotelevizionin Shqiptar.

Unë mendoj që “thembra e Akilit” e një farë qëndrese në rërë të këtij gjigandi, siç është Radiotelevizioni Shqiptar, në radhë të parë duhet kërkuar tek unifikimi i tarifave financiare.

Sot në Radiotelevizionin Shqiptar ka shumë ligje që janë firmosur dhe vulosur në periudhën e Adil Çarçanit.

Po ashtu, Radiotelevizionit Shqiptar sot nuk i afrohen artistët, krijuesit dhe gazetarët e mëdhenj, sepse nuk kanë shpërblimin që ata meritojnë. Mirëpo nëse në ekranin e RTSH-së nuk do të ketë programe të atilla që të jenë atraktive, që të kenë tërheqje dhe që të jenë me interes për publikun e gjerë dhe për interesat e tyre, atëherë Televizioni shqiptar do të jetë një televizion i zbehtë, ndonëse është televizioni që gjeografikisht është më i shikuari në të gjithë territorin shqiptar.

Unë mendoj se ajo që duhet bërë dhe që është thembra e kësaj çështjeje, dikush ndoshta mund të mos e vlerësojë siç e vlerësoj unë, është pikërisht niveli i financimit i të gjithë punonjësve.

Mendimi im është që administrata e Radiotelevizionit Shqiptar duhet të ketë një pagesë të unifikuar, por nga ana tjetër, krijuesit, duke futur gazetarët dhe krijuesit e tjerë artistikë, duhet të shpërblehen në bazë të performancës që bëjnë. Ka ardhur koha që të paktën të bëhet vetëm kjo gjë, duke i kërkuar Kuvendit Popullor dhe qeverisë që të bëhet ky ndryshim ligjor, sepse sipas meje është ilaçi i vetëm për të tërhequr njerëzit në ekranin e Radiotelevizionit Shqiptar. Është

mëkat, sepse të dalësh sot në Radiotelevizionin Shqiptar është gjëja më e lehtë, pasi kushdo që dëshiron të dalë del.

Cilat janë programet, sipas gjykimit tim, që e bëjnë më atraktivë dhe më tërheqës dhe më me interes Radiotelevizionin Shqiptar?

Po të vësh re Televizioni Shqiptar sot ka shumë kanale dhe kjo është diçka shumë e mirë që është bërë, duke punuar me kujdes dhe me dashuri, mirëpo nga ana tjetër ka shumë punonjës, por ka pak shikues, sepse ka pak reklama dhe reklama nuk mund të ketë po të mos ketë shikues. Nëse e keni vënë re në një program ndoshta nga më cilësorët e Radiotelevizionit Shqiptar në orët më të rëndësishme do të gjesh një reklamë, e cila do të jetë për Televizionin Shqiptar, ndërsa në një televizion privat do të gjesh 20 apo 30 reklama. Kjo nuk kërkon për mua koment, sepse ka të bëjë pikërisht me interesin që ka programacioni i Radiotelevizionit Shqiptar, i cili nuk i ngjall aq interes sa ngjallin ato të televizioneve private. Pra, kjo çështje, e cila është një nyje duhet zgjidhur, sepse do të jetë një pedanë për të filluar punën lidhur me përmirësimin kualitativ të programeve.

Sipas meje Radiotelevizioni Shqiptar ka shumë kohë, sidomos vitet e fundit, që i mungojnë programe artistike. Po ju marr vetëm një shembull, pavarësisht se jam një njeri që ka punuar edhe në fushën e humorit, në qoftë se Top Chanel ka 2-3 programe humoristike, Vizion Plusi 3 programe humoristike, Radiotelevizioni Shqiptar nuk ka asnjë program humoristik. Programet artistike janë jashtëzakonisht të kufizuara, ato janë vjetore ose një Festival i Këngës në Radiotelevizion ose një koncert për Vitin e Ri.

Duke u nisur nga kjo mendoj se duhet bërë një ndryshim në strukturën programore dhe në programacionin e Radiotelevizionit Shqiptar në mënyrë që të ngjallë interes te publiku.

Po ashtu, ka edhe një problem tjetër që është serioz, problemi i traditës në të gjitha fushat e jetës, i cili nuk gjen pasqyrimin profesional në ekranin e RTSH-së. Ndoshta thjesht sa për të larë gojën hera-herës jepen dokumentarë, skena dhe fragmente nga festivalet folklorike, ndonjë dokumentar nga jeta e një shkencëtari apo një sportisti. Për mua këtu ka një gjë që është parësore, pasi Radiotelevizioni Shqiptar ka një detyrim madhor për të lidhur brezat.

Sot, gjimnazistët shqiptarë, jam i bindur se shumica e tyre në Shqipëri nuk i njohin, jo vetëm nuk i vlerësojnë artistët apo shkencëtarët e mëdhenj të Shqipërisë, që nuk rrojnë më. Ky është një problem shumë serioz dhe është një nga detyrat e Radiotelevizionit Shqiptar, pasi duke qenë një televizion kombëtar dhe me përmasa të tilla dhe duke pasur detyrime ndaj popullit dhe kombit të tij është i detyruar të prodhojë dhe produktet e tyre të bëjnë pikërisht këtë lidhje.

Nëpër shkollat e mesme dhe 9-vjeçare nuk ka shumë njohuri lidhur me traditën shqiptare, por ai që është promotori i kësaj, sipas gjykimit tim, është gjithmonë Radiotelevizioni Shqiptar, i cili nëpërmjet mjeteve artistike, programeve, dokumentarëve, emisioneve, reportazheve apo telereportazheve mund të bëjë një lidhje dhe një prezantim dinjitoz.

Unë jam i bindur që gjimnazistët e Tiranës nuk e njohin se kush është Preng Jakova, ndërkohë që ai ka qenë një ndër kompozitorët më të mëdhenj shqiptarë. Po ashtu, jam i bindur se shumë shqiptarë, e kam fjalën gjithmonë për brezin e ri, nuk e njohin aktorin e madh shqiptar Tano Banushi, por njohin Bes Kallakun, një aktor shumë i mirë dhe me talent, por Tana Banushi është kolos.

Kush është ai që duhet t'i prezantojë këto figura të shquara? Është pikërisht Radiotelevizioni Shqiptar.

Përveç kësaj mendoj që Radiotelevizioni Shqiptar duhet të reduktojë administratën dhe punonjësit e “tepërt”. Unë quaj të “tepërt” atë kastë që rri nëpër kafene nga ora 10:00 deri në orën 14:00 pranë Radiotelevizionit, të cilët nuk kanë pse të rrinë nëpër kafene nëse do të ishin nëpër studiot e punës.

Në këtë kuptim mendoj se duhet parë ose riparë që të bëhet një reduktim logjik dhe të shihet më me nikoqirllëk. Një variant tjetër që e lehtëson administratën e Radiotelevizionit është edhe fakti që ky televizion ka në ngarkesë 3 televizione lokale. Unë nuk kam arritur kurrë ta kuptoj, edhe sot që flas nga këto pozita, se çfarë duhen 3 televizione lokale në Shqipëri, në Gjirokastrë, në Korçë dhe në Kukës. Përse duhen mbajtur 3 administrata dhe 3 televizione, ndërkohë që me 1, 2 apo 3 korrespondentë ato njoftime që bën televizioni lokal i bën Televizioni Shqiptar? Kjo do ta lehtësonte dhe do ta përmirësonte punën.

Në vend që të mbaj 10 veta, nuk e di me saktësi, në Gjirokastrë, mund të mbajë 2. Nëse ata i paguan sipas performancës së tyre në gazetari apo në krijimtari, atëherë do të sillnin cilësi në ekranin e Radiotelevizionit Shqiptar.

Pra, ideja ime përfundimtare, për të mos e zgjatur, sepse më duket sikur po bëj hartim, është se duhet përmirësuar kualiteti, pasi pa përmirësim të kualitetit televiziv, nuk do të ketë tërheqje të spektatorit shqiptar dhe Radiotelevizioni Shqiptar do të ngelet i zbehte, ndërkohë që i ka mundësitë për të kundërtën.

Në Europë ka radiotelevizione publike, siç është RAI, ERT-i në Greqi, por ama atje njerëzit vlerësohen sipas performancës dhe jo në mënyrë ushtarake, sipas gradave.

Unë nuk kam ndër mend të them se do të bëj çudira, në qoftë se gjendet si e arsyeshme kandidatura ime për kryetar të Këshillit Drejtues, por mund t'ju them duke u nisur nga eksperiencia shumëvjeçare, veçanërisht në bashkëpunim me Radiotelevizionin Shqiptar, por edhe me televizionet e tjera, do të mundësoja që të ndryshonte programacioni drejt kualifikimit profesional, duke shtuar programet artistike.

Më ka ngelur në mendje fakti që prej 4 vjetësh në Televizionin Shqiptar si program artistik mbahet një program me kuzhinierë, një herë kuzhinierë të rritur, një herë kuzhinierë plaka dhe një herë kuzhinierë kalamaj. Këto jepeshin 1 herë në javë, gjë, e cila ka 3-4 vjet dhe mbahet si program artistik. Unë nuk them që të mos bëhet kuzhina, sepse atë e bën e gjithë bota, por jo të kthehet si qëllim në vetvete.

Jua thashë këtë shembull për t'ju shpjeguar se duhet një farë kontrolli nëpërmjet Këshillit Drejtues të repertorit mediatic, i cili ushqen programet e Radiotelevizionit Shqiptar.

Kaq kisha për t'ju thënë. Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Bungo!

I ftoj anëtarët e komisionit t'i drejtojnë pyetje zotit Bungo.

Kush e dëshiron fjalën?

Po, zonja Kumbaro.

Mirela Kumbaro – Faleminderit!

Në fakt, më bëri shumë përshtypje njohja në detaje, për këtë dua ta falënderoj zotin Leka, për trajtimin që i bëri në aspektin teknik gjërave, që me sa duket kemi nevojë!

Kam të njëjtën pyetje që kisha për zotin Krisafi. Nga pikëpamja e legjislacionit, pasi shpeshherë kemi një menaxhim, një aspekt menaxherial dhe administrues, por kemi edhe një aspekt tjetër që është ligjor, i cili më pas na sjell përmirësime në aspektin menaxherial.

Pyetja që kam për zotin Bungo është, nëse ju do të ishit kandidati i përzgjedhur, cili do të ishte ai aspekt ligjor që do të ndryshonit në ligjin ekzistues, që do t'ju jepte një rol tjetër dhe do të ndryshonte diçka në funksionet e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit, me synim përmirësimin e aktivitetit të Radiotelevizionit Publik?

Të dashur kolegë, pyetja është e njëjtë me atë që kisha për zotin Krisafi. Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zonja Kumbaro!

Fjala për ju zoti Bungo.

Leka Bungo - Përgjigjen e kësaj pyetjeje e ka dhënë Kryeministri Edi Rama pardje, në Fier, kur vizitoi spitalin. Po jua them *mot a mot* si e ka thënë: Në këtë spital do të punojnë 200 mjekë turq dhe kaq shqiptarë dhe këta do të paguhen sipas performancës.

Atëherë, atje ku Kryeministri e gjen këtë ligj, atje duhet ta gjejë edhe Radiotelevizioni Shqiptar. Nëse nuk ka, duhet përpiluar, nëse ka, duhet kërkuar, pra duhet që Këshilli Drejtues t'ia kërkojë Kuvendit Popullor. Unë po ju them që të rriten rrogat në mënyrë disproporcionale, në asnjë mënyrë, as nuk po ju them që të cenohen ligjet, por po ju them që të propozohet një ligj i ri, i cili duhet të vlerësojë krijuesit, gazetarët dhe artistët, sipas performancës së tyre, sepse, nëse do të vazhdojnë kështu siç janë, në Radiotelevizionin Shqiptar nuk do të afrohen personalitete të artit dhe gazetarisë, ata që e bëjnë atraktivë dhe të shikueshëm, sepse nëse nuk e bëjnë të shikueshëm nuk ka reklamë dhe po nuk pati reklamë nuk ka para dhe po nuk pati para televizioni do të mjelë gjithmonë buxhetin e shtetit.

Pra, sipas logjikës sime mendoj se kjo është zgjidhja, tjetër nuk ka.

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Bungo!

A dëshiron ndonjë tjetër që do të bëj pyetje? Nuk ka.

Ju falënderoj për prezantimin tuaj zoti Bungo! Mund të largoheni.

Leka Bungo – Ju falënderoj!

Ramazan Gjuzi – Komisioni i dëgjoji të gjithë kandidatët për kryetar të KDRTSH-së.

Mbledhjen e ardhshme do t'jua njoftojmë nëpërmjet sekretarisë...

Po, zoti Ulqini.

Musa Ulqini – Zoti kryetar, mendoj që ekspertiza që kemi ne në komision, kur njofton zotërinjtë apo zonjat që vijnë për të raportuar ose për t'u paraqitur, siç ishte rasti i sotëm, duhet t'ju bëj me dije që parlamenti quhet Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe nuk quhet Kuvendi Popullor. Kuvendi Popullor i takon një kohe të kaluar. Mendoj se diçka e tillë duket keq për faktin që ne na ndjekin dhe të thuash sot Kuvendi Popullor, i cili është një atavizëm i kohës së komunizmit, tingëllon shumë keq.

Ju lutem, nëse ka ndonjë problem të shihet mirë mënyra e komunikimit, shkresat e të tjera! Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit!

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Ditën e mirë dhe ju uroj të kaloni një ditë të këndshme!

Për mbledhjen e ardhshme, të cilën e kemi me dyer të mbyllura për caktimin e kandidatit për kryetar, do t'ju njoftojmë.

MBYLLET MBLEDHJA